

VENDIM
Nr.786, datë 29.9.2010

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER I
SHKENCAVE”, PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011**

(Ndryshuar me VKM nr. 901, datë 10.11.2010; nr. 78, datë 2.2.2011)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit” dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2010 - 2011, të jenë 6715. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|--------------|
| <i>a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”</i> | <i>6525;</i> |
| <i>b) Kuotat për programe të dyta studimi</i> | <i>0;</i> |
| <i>c) Kuotat për transferimin e studimeve</i> | <i>100;</i> |
| <i>ç) Kuotat për të huajt</i> | <i>50;</i> |
| <i>d) Kuotat për të verbrit</i> | <i>20;</i> |
| <i>dh) Kuotat për romët/ballkano-egjiptianët</i> | <i>20.</i> |

2. Kuotat e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, përbëhen nga:

a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”, për aplikantët brenda territorit të vendit, 5873;

b) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”, për aplikantët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit 652.

3. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, paraqitur në tabelën nr.1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të dytë, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij vendimi, ndahen ndërmjet aplikantëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Republika e Kosovës, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë. Administrimi i këtyre kuotave kryhet në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet vendeve dhe akteve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë. Këto kuota pranimi të ndara sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi, janë në masën 10% të kuotës përkatëse, paraqitur në tabelën nr.1/1, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Kuota e pranimeve për të verbrit ndahen për aplikantët me statusin e të verbrit, nga MASH-i, sipas listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve.

6. Kuotat e pranimeve për romët dhe ballkano-egjiptianët ndahen nga MASH-i, sipas listës së hartuar nga shoqatat respektive, përkatësisht, Shoqata Kombëtare të Romëve dhe

Shoqata Kombëtare të Ballkano-Egjiptianëve.

7. Kuotat e pranimit për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucione publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në ciklin e dytë të studimeve, sipas shkronjës “d”, të pikës 1, të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ato të shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy- apo shumëpalëshe ndërmjet vendeve.

8. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi dhe transferimi i studimeve, të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bazuar edhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

9. Çdo program studimi i ciklit të dytë funksionon, në vitin e parë, për vitin akademik 2010-2011, në rast se atë e ndjekin të paktën 10 studentë.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kriteret e pranimit të aplikantëve dhe i bëjnë ato publike, paraprakisht.

11. *Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”, në vitin akademik 2010-2011, si dhe tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që ndjekin një program të dytë studimi, janë sipas tabelës nr.2/1, bashkëlidhur këtij vendimi.*

12. Aplikantët që do të fitojnë të drejtën në një program studimi të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2010-2011, dhe që u përkasin shtresave sociale, si: të verbër të shurdhër, invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, fëmijë jetimë, fëmijë romë, ballkano-egjiptianë, fëmijë të policëve dhe ushtarakëve të rënë për shkak të detyrës dhe të ish-të përndjekurve politikë, paguajnë një kuotë në masën 50 për qind të tarifës së shkollimit. Këtë të drejtë do ta kenë edhe studentët e viteve më të larta, që u përkasin po këtyre shtresave sociale.

13. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi, pagesa e së cilës bëhet me këste të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë. Studentët përsëritës i nënshtrohen tarifës së shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdojnë rregullisht studimet.

14. Në çdo program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, studentët e vitit të parë, që kanë përfunduar me Medalje të Artë ciklin e parë të studimeve, dhe studentët e vitit të dytë, që kanë përfunduar shkëlqyeshëm vitin e parë, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik 2010-2011.

15. Shtetasit e huaj që do të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, në kuadër të marrëveshjeve ndërshtetërore, është parashikuar ndryshe.

16. Transferimet e studimeve, në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas shkronjës “c”, të pikës 1 të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore, statutet dhe rregulloret e tyre.

17. Studentët që transferojnë studimet, nga një program studimi apo nga programe të mëparshme studimi të ciklit të dytë, në një program tjetër studimi, në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës së përgjithshme vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.

18. Rishpërndarja e kuotave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat mbeten të parealizuara, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1

TABELA E KUOTAVE “MASTER I SHKENCAVE” 2010-2011

		UT	UPT	UBT	UE	USH	UK	UGJ	UV	UD	UST	Shuma
Nr.	Emërtimet e programeve të studimit	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	
1	Biologji mjedisore	15				30						45
2	Biologji molekulare	30										30
3	Fizikë	20										20
4	Bioteknologji	20										20
5	Kimia industriale dhe mjedisore	40										40
6	Inxhinieria e proceseve kimike	40										40
7	Shkencat dhe teknologjitë ushqimore	40										40
8	Kimi	40										40
9	Matematikë	45							80			125
10	Matematikë dhe Financë											80
11	Inxhinieri Matematike dhe Informatikë	45										45
12	Informatikë	40										40
13	Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor dhe turistik	100										100
14	Përkth. teknik-letrar dhe interpretim	100										100
15	Gjuhësi	125			20							145
16	Letërsi	113										113
17	Histori	37										37
18	Gjeografi	62										62
19	Arkeologji	19										19
20	Trashëgimi Kulturore	19			30							49
21	Marrëdhënie Ndërkombëtare	25										25
22	Gazetari	100										100
23	Përkatësi gjinore dhe zhvillim	75										75
24	Psikolog shkollor/Organizacional	50										50
25	Psikolog Klinik i Zhvillimit dhe Marrëdh.	50										50
26	Filozofi Sociale	75					20					95
27	Teori Politike	62										62
28	Sociologji e zhvillimeve shoqërore	63										63
29	Punë Sociale	125										125
30	Menaxhim Infermieror	150										150
31	Teknikë laborator	40										40
32	Fizioterapi	40										40
33	Mami	30										30
34	Imazheri	40										40
35	Shëndet Publik	35										35
36	Inxhinieri Elektronike		25									25
37	Inxhinieri e Telekomunikacionit		25									25
38	Inxhinieri Informatike		25									25
39	Inxhinier Elektrike											80
40	Inxhinieri Elektrike (Energjetikë, Aut. i Industrisë)		60									60
41	Inxhinieri Mekanike		70									70
42	Inxhinieri Materiale		30									30
43	Inxhinieri Tekstili dhe Mode		30									30
44	Inxhinieri Gjeologjike		60									60
45	Inxhinieri e Burimeve Natyrore		40									40
46	Inxhinieri Gjeofizike		15									15
47	Inxhinieri Gjeomjedisi		20									20
48	Inxhinieri Mjedisi		60									60
49	Inxhinieri Ndërtimi		120									120
50	Inxhinieri Hidroteknike		35									35
51	Inxhinieri Gjeodezi		35									35
52	Inxhinieri Agrare (Hortik. Mbrojtje bim., Zootek., Akuak.)			130								130
53	Inxhinieri Agromjedisi (Agromjedis dhe Ekologji)			50								50
54	Inxhinieri Agroushqimore			50								50
55	Vreshtari-Enologji			20								20
56	Inxhinieri Përpunim Druri			30								30
57	Inxhinieri Pyjore			30								30
58	Ekonomi dhe Politika Agrare			70								70
59	Financë-Kontabilitet			100								100
60	Financë											0

[illegible]

	kontabilitet auditim													
100	Në fushën menaxhim- turizëm	30												30
101	Në fushën marketing	30												30
102	Në fushën sisteme informacioni në ekonomi	30												30
103	Në fushën kërkime operacionale në menaxhim	30												30
104	Në fushën e ekonomiksit	30												30
105	Në fushën administrim biznesi me përqendrim	60												60
106	Në fushën e administrimit publik	30												30
107	Inxhinieri navale							120						120
108	Shkenca kompjuterike							40						40
109	Shkenca kompjuterike							0						0
110	Shkenca sportive									31				31
111	Master shkencor në Real Estate							70						70
112	Master në fushën e mbrojtjes											65		65
113	Studime gjuhësore										20			20
114	Studime letrare										20			20
115	Studime historike										20			20
116	Studime etnologjike										20			20
117	Studime arkeologjike										15			15
118	Legjislatoni dhe institucionet e BE-së	30												30
119	Politika dhe qeverisja në Europë	30												30
120	Diplomacia dhe Marrëdhëniet ndërkombëtare	30												30
121	Gjuhësi							20						20
122	Letërsi							20						20
	Shuma	3713	790	600	166	270	40	75	500	180	31	95	65	6525

Tabela nr. 2

TARIFAT VJETORE TË SHKOLLIMIT NË VITIN AKADEMIK 2009-2010 DHE TARIFAT
E SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT QË DO TË REGJISTROHEN NË VITIN E PARË,
PËR TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË "MASTER I
SHKENCAVE", NË VITIN AKADEMIK 2010-2011

	Për vitin 2009-2010	Për vitin 2010-2011
a) Universiteti i Tiranës:		
I. Fakulteti i Shkencave të Natyrës		
i) Fizikë	44 000	48 000
ii) Matematikë	40 000	48 000
iii) Të gjitha programet e tjera	56 000	67 200
II. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja:	48 000	57 600
III. Fakulteti Histori-Filologji		
i) Arkeologji	72 000	86 400
ii) Trashëgimi kulturore	72 000	86 400
iii) Të gjitha programet e tjera	48 000	57 600
IV. Fakulteti i shkencave Sociale	60 000	72 000
b) Universiteti Politeknik i Tiranës:		
I. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit:	56 000	72 000
II. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	48 000	72 000
III. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	40 000	45 000
IV. Fakulteti Gjeologji Miniera	40 000	38 000
V. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	60 000	72 000
c) Universiteti Bujqësor i Tiranës:		
I. Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	36 000	43 200
II. Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	40 000	48 000
III. Fakulteti i Shkencave Pyjore	36 000	43 200
IV. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	48 000	57 600
d) Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	40 000	48 000
e) Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	50 000	55 000
f) Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	50 000	55 000
g) Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër	40 000	48 000
k) Universiteti "F.S.Noli" Korçë		48 000
l) Universiteti i Sporteve të Tiranës		95 000
m) Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan:		
i) Matematikë e zbatuar	40 000	48 000
ii) Të gjitha programet e tjera	40 000	50 000

TARIFAT VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E DYTA TË STUDIMIT TË
 CYKLIT TË DYTË, NË VITIN AKADEMIK 2009-2010, SI DHE TARIFAT VJETORE TË
 SHKOLLIMIT NË PROGRAMIN "MASTER I SHKENCAVE", PËR VITIN AKADEMIK
 2010-2011

	Për vitin 2009-2010	Për vitin 2010- 2011
a) Universiteti i Tiranës:		
I. Fakulteti i Shkencave të Natyrës		
i) Fizikë	95 000	99 750
ii) Matematikë	95 000	99 750
iii) Të gjitha programet e tjera	150 000	157 500
II. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	95 000	99 750
III. Fakulteti Histori-Filologji		
i) Arkeologji	200 000	210 000
ii) Trashëgimi kulturore	200 000	210 000
iii) Të gjitha programet e tjera	95 000	99 750
IV. Fakulteti i Shkencave Sociale	95 000	99 750
b) Universiteti Politeknik i Tiranës:		
I. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	200 000	210 000
II. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	200 000	210 000
III. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	150 000	157 500
IV. Fakulteti Gjeologji Miniera	150 000	157 500
V. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	250 000	262 500
c) Universiteti Bujqësor i Tiranës:		
I. Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	150 000	157 500
II. Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	200 000	210 000
III. Fakulteti i Shkencave Pyjore	95 000	99 750
IV. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	95 000	99 750
d) Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	95 000	96 000
e) Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	95 000	96 000
f) Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	95 000	96 000
g) Universiteti "F.S.Noli" Korçë		96 000
k) Universiteti i Sporteve të Tiranës		110 000
l) Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan:		
i) Matematikë e zbatuar	80 000	84 000
ii) Të gjitha programet e tjera	95 000	95 000
m) Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë		
i. Arkeologji	200 000	200 000

TABELA 2/1

TARIFAT VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT QË DO TË REGJISTROHEN
NË VITIN E PARË, PËR TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË

“MASTER I SHKENCAVE”, NË VITIN AKADEMIK 2010-2011

(Ndryshuar me VKM nr. 901, datë 10.11.2010; nr. 78, datë 2.2.2011)

a) Universiteti i Tiranës:

I. Fakulteti i Shkencave të Natyrës:

i) Fizikë	48.000 lekë
ii) Matematikë	48.000 lekë
iii) Të gjitha programet e tjera	67.200 lekë

II. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

57.600 lekë

III. Fakulteti Histori-Filologji

i) Arkeologji	86.400 lekë
ii) Trashëgimi kulturore	86.400 lekë
iii) Të gjitha programet e tjera	57.600 lekë
IV. Fakulteti i Shkencave Sociale	72.000 lekë
V. Fakulteti i Mjekësisë	240.000 lekë
VI. Fakulteti Ekonomik	80.000 lekë
VII. Fakulteti i Drejtësisë	60.000 lekë
VIII. Fakulteti i Infermierisë	240.000 lekë
IX. Instituti i Studimeve Europiane	80.000 lekë

b) Universiteti Politeknik i Tiranës:

I. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	72.000 lekë
II. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	72.000 lekë
III. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	45.000 lekë
IV. Fakulteti i Gjeologji Miniera	40.000 lekë
V. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	72.000 lekë
VI. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	40.000 lekë

c) Universiteti Bujqësor i Tiranës:

I. Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	43.200 lekë
II. Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	48.000 lekë
III. Fakulteti i Shkencave Pyjore	43.200 lekë
IV. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	57.600 lekë

d) Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë 48.000 lekë

e) Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër 55.000 lekë

f) Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës 55.000 lekë

g) Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër 48.000 lekë

k) Universiteti “F.S.Noli”, Korçë 48.000 lekë

l) Universiteti i Sporteve të Tiranës 95.000 lekë

m) Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan:

i) Matematikë e zbatuar	48.000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera	60.000 lekë

n) Qendra e Studimeve Albanologjike

100.000 lekë